



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.494, datë 21.10.2020

PËR

**MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË GJYQTARËVE NË TRAJNIMIN VAZHDUES
PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR PERIUdhËN
TETOR – DHJETOR 2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 68, 88 shkronja “a” dhe “c”, 272 pika 3 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 5 pika 3 dhe 6 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, bazuar në kërkesën dhe materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës,

V E N D O S I :

1. Të miratojë pjesëmarrjen e gjyqtarëve në programin e formimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Tetor 2020 – Dhjetor 2020, sipas listës së pjesëmarrësve për çdo aktivitet trajnimi bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij.
2. Gjyqtarët e përfshirë në listën sipas pikës 1 të këtij vendimi, marrin pjesë në aktivitetet trajnuese, në përputhje me rregullat e parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës.
3. Gjyqtarët duhet të marrin masa organizative për të mos penguar ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore ose asaj për të cilën janë komanduar, në ditët që do të marrin pjesë në aktivitetin trajnues.
4. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, gjykatave dhe institucioneve të tjera ku gjyqtarët, sipas listës së miratuar bashkëlidhur këtij vendimi, ushtrojnë detyra të tjera si gjyqtarë të komanduar.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR